



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2022

**MBLEDHJA Nr. 23,**  
**Datë 31.05.2022, ora 13:30**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 31.05.2022, ora 13:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 23 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 24.05.2022
2. Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2022
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 390, seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 377, seria T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017
6. Mbi procedurën e licencimit të shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2000 kW
7. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALB - Energy” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017
8. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

10. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e barrës siguroese mbi 100% të kuotave të shoqërisë “Selishte” sh.p.k. në favor të “Bankës së Parë të Investimeve – Albania” sh.a.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**